



Pranuar / Dorezuar Prijmjenol/Prodato Received/Delivery	21.04.2022	2	viti god. year.
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRPMSHCK	2308	2022	113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.213/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.213/2022 të datës 08.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.213/2022 e datës 08.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Prizrenit sipas Akt Emërimit me numër 01Nr.307 të datës 21.02.2021 në vendin e punës "Nëpunës i Shërbimeve Sociale", të cilit sipas Vendimit me numër 01-118-96985 të datës 30.06.2021 të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Prizrenit i përfundon marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Ankuesi me datë 30.09.2021 parashtron kërkesën me numër të protokollit 02-120/01-0153306/21 tek organi i punësimit kërkesën për kompensim material me rastin e pensionimit dhe shpërblimit jubilar, pasi që ankuesi nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e tij ankuesi përsëri parashtron kërkesë me datë 18.01.2022 tek organi i punësimit ndërsa organi i punësimit me datë 03.03.2022 i kthen përgjigje ankuesit lidhur me kërkesën e tij.

Ankuesi Shaban Basha, i pa kënaqur me përgjigjen e datës 03.03.2022 të organit të punësimit me

datë 04.03.2022 parashtron ankesë nëpërmjet Postës së Kosovës ankesën me numër të protokollit 1438/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 08.03.2022 me pretendim ankimor për kompensim me rastin e pensionimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 15.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Komunën e Prizrenit. Më datë 14.04.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prizrenit me provat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/11.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 08.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin i datës 30.06.2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës; Përgjigja në kërkesë e datës 03.03.2022; Kërkesa e datës 18.01.2022 për shkak heshtjes administrative; Akt emërimi i ankuesit i datës 21.02.2012; Kërkesa e ankuesit e datës 30.09.2021; Provat shtesë të datës 18.03.2022 të parashtruara nga ankuesi si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është *e pa bazuar, sepse:*

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokollit 307 të datës 21.02.2012 ka qenë i punësuar në pozitën e punës „Nëpunës i Shërbimeve Sociale“, ndërsa sipas vendimit me numër 01-118-96985 të datës 30.06.2021 të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Prizrenit me datë 30.06.2021 i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Ankuesi me datë 30.09.2021 parashtron kërkesë me numër të protokollit 02-120/01-0153306/21 për kompensim material me rastin e pensionimit dhe shpërblimit jubilar, tek organi i punësimit, pasi që ankuesi nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e tij ankuesi përsëri parashtron kërkesë me datë 18.01.2022 tek organi i punësimit ndërsa organi i punësimit me datë 03.03.2022 i kthen përgjigje ankuesit me të cilin e njofton lidhur me refuzimin e kërkesës nga organi i punësimit. Ankuesi me datë 04.03.2022 nëpërmjet Postës së Kosovës parashtron ankesë me numër të protokollit 1438/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 08.03.2022 me pretendim ankimor për kompensim e tri pagave dhe shpërblimin jubilar me rastin e pensionimit sipas Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore analizoi bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë konstatoi se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014 ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar



se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes se Përgjithshme Kolektive pas datës 31.12.2017. Andaj pretendimi ankimor i ankuesit mbi këtë bazë juridike është i pabazuar ngase

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është në fuqi në kohën kur ankuesi ka parashtruar pretendimet ankimore, dhe rrjedhimisht edhe drejta e kompensimit të pagave jubilarë dhe përcjellëse me rastin e pensionimit në mënyrë retroaktive mbi këtë bazë juridike është e pabazuar.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.213/2022

Valentina Kaçandoli BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

